

VENDIM
Nr. 548, datë 27.7.2016

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT¹
(Ndryshuar me VKM nr.874, datë 14.12.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së institucioneve qendrore buxhetore, funksionarët dhe punonjësit e të cilëve janë subjekte përfituese nga skema e sigurimit shtetëror suplementar, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së funksioneve kushtetuese dhe detyrave në administratën publike, ku vitet e kryera të punës do të njihen si vite shërbimi për efekt të përfitimit të pensioneve shtetërore suplementare, sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Vite shërbimi për efekt të përfitimeve sipas këtij ligji, për funksionet “Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, “Gjeneral i Forcave të Armatosura” dhe “punonjësit e Policisë së Shtetit të rolit madhor” do të njihen vitet e punës në këto funksione nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 27/2015. Personat që kryejnë këto funksione, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga pagesa e kontributit suplementar, sipas nenit 5, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për efekt të zbatimit të shkronjës “b”, të pikës 8, të nenit 1, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, “drejtuesit e Policisë së Shtetit të rolit madhor” janë ata të përcaktuar në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të cilët janë aktivë dhe në funksion në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në vazhdim. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 27/2015 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kalimi i kontributeve të derdhura nga këto funksione dhe, për pasojë, i periudhave të tyre të sigurimit nga skema suplementare, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, në skemën për pensionet shtetërore suplementare bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

4. Vite shërbimi, për efekt të përfitimeve sipas këtij ligji, për “personelin specialist” dhe “personat e barazuar me ta në funksion” do të njihen vitet e punës të kryera në një nga institucionet qendrore buxhetore, sipas listës së institucioneve që përmenden në pikën 1, të këtij vendimi. Me termin “personel specialist”, për efekt të përfitimit të pensioneve suplementare, do të kuptojmë të gjithë punonjësit me arsim të lartë të nivelit ekzekutiv, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pavarësisht nga profesioni, dhe që nuk kryejnë asnjë funksion drejtues.

5. Institucionet e përcaktuara në lidhjen nr. 1, të këtij vendimi, në listëpagesën që dorëzojnë pranë organeve tatimore janë të detyruara t’u përmbahen emërtimeve të funksioneve/pozicioneve/detyrave të përcaktuara në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Për emërtimet e funksioneve apo pozicioneve të personave të punësuar, që do të përfshihen për herë të parë në skemën e sigurimeve suplementare apo janë të përfshirë, por ndryshojnë grupimin përkatës, sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kontributet për sigurimin suplementar duhet të derdhen sipas përqindjeve të miratuara në legjislacion, në bazë të grupimit ku ata bëjnë pjesë.

¹ VKM nr.548, datë 27.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.147/2016.
VKM nr.874, datë 14.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.247/2016.

7. *Krijimi i institucioneve të reja, ndryshimi i emërtimeve ekzistuese të funksioneve, shtimi i emërtimeve të reja në strukturën e institucioneve apo ndryshimi i grupimeve, që nuk përfshihen në listën e miratuar në këtë vendim, miratohen me akt ligjor apo nënligjor.*

8. Personave të punësuar në institucionet qendrore buxhetore, të cilët kanë paguar kontribute suplementare, pavarësisht ndryshimit të emërtimeve të institucionit, e gjithë perioda për të cilën janë derdhur këto kontribute do t'u njihet si vjetërsi shërbimi.

9. Me termin “pagë referuese” kuptohet paga bruto e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion apo detyrë në momentin e lindjes të së drejtës për përfitime shtetërore suplementare. Paga bruto llogaritet si shumë e elementeve përbërëse të saj, sipas strukturës së pagës, miratuar me aktin ligjor/nënligjor përkatës.

10. *Në rastet kur në momentin e lindjes të së drejtës për përfitime suplementare, në aktet ligjore apo nënligjore përkatëse nuk ekziston institucioni dhe mungon funksioni/pozicioni/detyra dhe paga për atë funksion/pozicion/detyrë, paga referuese përcaktohet nga Departamenti i Administratës Publike, duke bërë njësimin e funksionit/pozicionit/detyrës, për të cilin nuk ka pagë, me funksione/pozicione të ngjashme.*

11. Njehsimi i pagës referuese nga DAP-i bëhet duke marrë parasysh njehsimin e institucioneve për efekt page, si më poshtë vijon:

a) “Deputetët e legjislaturës 1991–1992”, të cilët, në të njëjtën kohë, punonin në funksione dhe detyra të tjera, si pagë referuese do të kenë pagën referuese të deputetit, në momentin e daljes së tyre në pension;

b) “Sekretarët e Shtetit”, në Kryeministri apo në ministrinë e linjës, të cilët kanë qenë dekretuar si anëtarë të Këshillit të Ministrave, do të kenë pagën referuese të anëtarit të Këshillit të Ministrave;

c) Pozicionet e punës në prokuroritë ushtarake të apelit, pa përfshirë punonjësit administrativë, për efekt të pagës referuese njehsohen me pozicionet homologe në gjykatën e rrethit gjyqësor;

ç) Funksioni/pozicioni “Kryetar i Këshillit të Rrethit” dhe “Kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist”, njehsohen me funksionin e “Kryetarit të Bashkisë”;

d) Pozicionet e punës në drejtoritë e përgjithshme të bankave të nivelit të dytë, nga “titullar institucioni” deri te “specialist”, njehsohen me pozicionet homologe të punës në drejtoritë e përgjithshme në varësi të ministrave të linjës të grupit të parë;

dh) *Pozicioni “Inspektor në Këshillin e Ministrave” njësohet rast pas rasti me pozicione të ngjashme në Kryeministri, duke gjykuar mbi përshkrimin e punës dhe në përputhje me strukturën dhe organikën e këtij institucioni;*

e) *Pozicionet nga “Titullar institucioni” deri te “Specialist” në ish-Arbitrazhin e Shtetit, pa përfshirë degët në rrethe, njësohen me pozicionet homologe të institucioneve të pavarura;*

ë) *Pozicionet nga “titullar i institucionit” deri te “specialist” në ish-Komitetin e Shkencës dhe Teknologjisë njësohen me pozicionet homologe në ministrinë e linjës.*

Për efekt të përcaktimit të pagës referuese nga Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të pikave 10 e 11, të këtij vendimi, shtesat për kualifikim dhe për natyrë të veçantë pune nuk do të merren parasysh. Këto shtesa do të llogariten si pjesë e pagës bruto vetëm në rastet kur nëpunësi/punonjësi i ka përfituar këto shtesa gjatë kohës që ka qenë i punësuar në një nga pozicionet që përfshihen në lidhjen nr.2.

12. Personat e interesuar paraqesin pranë DAP-it kërkesën për përcaktimin e pagës referuese të funksionit/pozicionit/detyrës, që do të shërbejë si bazë për përfitimin nga skema e sigurimeve shtetërore suplementare.

13. Funksionarët apo nëpunësit që kryejnë funksione kushtetuese apo ushtrojnë detyra në institucionet e administratës publike dhe që janë përfitues të skemës së sigurimeve suplementare, në momentin e largimit nga funksioni përfitojnë pagesë kalimtare, si më poshtë vijon:

a) Funksionarit të grupit të parë, të shkronjës “a”, të pikës 8, të nenit 1, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, pas largimit nga funksioni i paguhen 3 (tri) paga mujore të funksionit dhe, duke filluar nga muaji i katërt, sigurimet shoqërore i paguajnë 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa ka punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion;

b) Funksionarit të grupit të parë, të shkronjës “b”, të pikës 8, të nenit 1, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, pas largimit nga funksioni i paguhen 2 (dy) paga mujore të funksionit dhe, duke filluar nga muaji i tretë, sigurimet shoqërore i paguajnë 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa ka punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion;

c) Funksionarit të grupit të dytë, të shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 1, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, pas largimit nga funksioni i paguhen 2 (dy) paga mujore të funksionit dhe, duke

filluar nga muaji i tretë, sigurimet shoqërore i paguajnë 40 për qind të pagës referuese bruto, për atë kohë sa ka punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

14. “Pagesa pas ndërprerjes së funksionit të fundit” bëhet çdo muaj, nga punëdhënësi i fundit, për atë muaj sa përcaktohet në nenin 7, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar.

15. “Pagesa kalimtare” dhe “pensionet shtetërore suplementare” të të gjitha llojeve caktohen, administrohen dhe paguhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

16. Në kuptim të paragrafit të dytë, të nenit 9, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, masa e pensionit suplementar për personat që kanë kryer funksione të përcaktuara në grupin e parë, shkronja “a”, nuk duhet të jetë më e madhe se 60 për qind dhe, për funksionet në grupin e parë, shkronja “b”, nuk duhet të jetë më e madhe se 50 për qind e pagës referuese të funksionit më të lartë. Në rastet kur personi, në varësi të periudhave të ushtrimit të funksioneve, përfiton pension suplementar nga të dyja grupet e sipërpërmendura, atëherë masa e përgjithshme e pensionit suplementar që do të marrë nuk mund të kalojë 60 për qind të pagës referuese të funksionit më të lartë.

17. Në kuptim të shkronjës “b”, të nenit 10, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, me “pension pleqërie” kuptojmë pensionet e pleqërisë të caktuara sipas neneve 31, pikat 1 e 2, dhe 31/1.

18. Personat e interesuar për të përfituar pagesë kalimtare apo pensione shtetërore suplementare duhet të paraqesin pranë organeve të sigurimeve shoqërore, ku kanë qendrën e tyre të banimit, kërkesën për përfitim, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim, si më poshtë vijon:

a) Për të përfituar pagesën kalimtare:

i) vërtetim nga qendra e punës për largimin nga funksioni a detyra;

ii) vërtetim për vitet e shërbimit në funksion apo detyrë;

iii) vërtetim për pagën referuese;

iv) deklaratë nëse është i punësuar dhe pagën që merr ose deklaratë që nuk është i punësuar;

v) vërtetim të gjendjes gjyqësore.

b) Për pensionet shtetërore suplementare:

i) vërtetim/e nga qendra/t e punës për funksionet a detyrat e kryera, për të cilat i lind e drejta për pension dhe vitet e shërbimit për funksionin a detyrën;

ii) vërtetimin/et e pagës për funksionin apo detyrën;

iii) vërtetim të gjendjes gjyqësore.

19. Për personat që kanë kryer funksione kushtetuese dhe punonjësit e administratës publike, institucionet e të cilave janë suprimuar apo nuk ekzistojnë më, dokumentacioni për vjetërsinë në shërbim do të plotësohet nga Arkiva Qendrore e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në rastet kur institucionet, të cilat kanë marrë në administrim dokumentacionin e vjetërsisë në punë, nuk e kanë dorëzuar pranë organeve të sigurimeve shoqërore, ato janë përgjegjëse për plotësimin e tyre.

20. Personat, të cilët në të njëjtën kohë ushtrojnë një detyrë apo funksion që bën pjesë si në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, ashtu edhe në një skemë tjetër suplementare apo trajtim të veçantë, për efekt të derdhjes së kontributeve dhe përfitimeve, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 27/2015, e në vazhdim kanë të drejtë të zgjedhin njërin nga skemat.

21. Shpenzimet administrative për funksioni-min e kësaj skeme të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

22. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e rregullores dhe dokumentacionit për zbatimin e këtij vendimi dhe Ministria e Financave për mbulimin e efekteve financiare të institucioneve që japin pagesën kalimtare pas ndërprerjes së funksionit.

23. Vendimi nr. 382, datë 20.5.1996, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

24. Institucionet që kanë qenë pjesë në skemën e sigurimeve suplementare dhe që, pas miratimit të këtij vendimi, nuk do të jenë më pjesë e listës së miratuar me këtë vendim, nuk do të derdhin kontribute për sigurime suplementare për punonjësit e tyre. Vitet e punës të kryera në një nga funksionet apo detyrat e pasqyruara në lidhjen nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, do të njihen deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

LISTA E INSTITUCIONEVE QENDRORE BUXHETORE

Institucione kushtetuese e të pavarura	
	Presidenca
	Kuvendi i Shqipërisë
	Kryeministria
	Gjykata Kushtetuese
	Gjykata e Lartë
	Prokuroria e Përgjithshme
	Ministritë
	Kontrolli i Lartë i Shtetit
	Shërbimi Informativ Shtetëror
	Avokati i Popullit
Institucione të tjera të pavarura të krijuara me ligj	
	Autoriteti i Konkurrencës
	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
	ILDKP-ja dhe Konflikti i Interesave
	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
Institucione në varësi të Kryeministrit	
	Akademia e Shkencave
	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile
	Agjencia e Prokurimit Publik
	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
	Agjencia Telegrafike Shqiptare
	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike
	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
	Departamenti i Administratës Publike
	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit
	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
	Inspektorati Qendror
	Instituti i Statistikës
	Komisioni i Prokurimit Publik
	Komiteti Shtetëror i Minoriteteve
	Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit
	Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale
	Qendra e Ofrimit të shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
	Agjencia e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog
	Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR)
	Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER)

LISTA E FUNKSIONEVE KUSHTETUESE DHE DETYRAVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE, PËR TË CILAT VITET E PUNËS TË KRYERA DO TË NJIHEN SI VITE SHËRBIMI PËR EFEKT TË PËRFITIMIT TË PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE SIPAS LIGJIT NR. 8097, DATË 21.3.1996, TË NDRYSHUAR

Për grupin e parë germa “a”, pika 8, e nenit 1, të këtij ligji:

President i Republikës;
Kryetari i Kuvendit;
Kryetar i Këshillit të Ministrave/Kryeministër;
Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave/zëvendëskryeministër;
Anëtar i Këshillit të Ministrave/ministër;
Zëvendëskryetar i Kuvendit

Personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave janë:

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
Prokurori i Përgjithshëm;
Shef i shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
Kryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;
Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
Kryetar i Gjykatës së Lartë.

Për grupin e parë germa “b”, e pikës 8, të nenit 1, të këtij ligji:

Deputetët e Kuvendit;
Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
Anëtarët e Gjykatës së Lartë;
Avokati i Popullit;
Inspektor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale;
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
Gjeneralët e Forcave të Armatosura;
Punonjës të Policisë së Shtetit të rolit madhor.

Për grupin e dytë germa “a”, e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

Sekretar shteti²;
Zëvendësministër;
Zëvendësprokuror i përgjithshëm³;

dhe personat e tjerë të barazuar me ta, si më poshtë:

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive;
Zëvendëskryetar i Autoritetit të Medias Audiovizive;
Anëtar i Autoritetit të Medias Audiovizive;
Kryetari i Arbritrazhit të Lartë Shtetëror⁴;
Kryetari i Akademisë së Shkencave;
Drejtori i përgjithshëm i RTV-së;
Drejtori i ATSH-së;
Drejtor departamenti pranë Kryeministrit;
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike;
Komisioner në Avokatin e Popullit;
Zëvendëskryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;
Drejtor i përgjithshëm i Tatimeve;
Drejtor i përgjithshëm i Doganave;
Drejtori i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
Drejtori i përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit;
Drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik;
Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
Drejtor i përgjithshëm i Institutit të Statistikave;
Zëvendësguvernatori i Bankës së Shqipërisë;
Inspektor i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë;

² Nuk ekziston më, por është në ligj.

³ Nuk ekziston më, por është në ligj.

⁴ Nuk ekziston më, por është në ligj.

Kancelar i Gjykatës së Lartë;
Kryeinspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
Prefekti;
Kryetari i Këshillit të Qarkut;
Kryetari i Bashkisë;
Drejtore i përgjithshëm i Institutit të Integritetit për të Përndjekurit Politikë;
Inspektor i përgjithshëm i Shërbimit Informativ Shtetëror;
Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës;
Anëtar i Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës;

Sekretar i Përgjithshëm në:
Presidençë;
Kuvend;
Këshillin e Ministrave/Kryeministrit;
Ministritë e linjës;
Prefekturë;
Këshillin e rrethit;
Këshillin e qarkut;
Bashki;

Institucionet qendrore buxhetore, kushtetuese dhe të pavarura

Drejtore/shëf kabineti i:
Presidentit;
Kryetarit të Kuvendit;
Kryetarit të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit;
Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave/zëvendëskryeministrit;
Ministrit;

Institucioneve qendrore buxhetore, kushtetuese dhe të pavarura (sipas listës së institucioneve të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi).

Këshilltar/zëdhënës në kabinetin e:

Presidentit;
Kryetarit të Kuvendit;
Kryetarit të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit;
Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave/zëvendëskryeministrit.

Ndihmës i:

Presidentit;
Kryeministrit;
Zëvendëskryeministrit.

Drejtore i përgjithshëm në Kuvend

Këshilltar i grupit parlamentar

Për grupin e dytë germa “b”, e pikës 9, të nenit I të këtij ligji:

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
Sekretar Shkençor në Akademinë e Shkencave;
President i Komitetit Olimpik Shqiptar;
Avokat Shteti;

Sekretar i Presidentit;
Drejtore njësie në Kryeministri;
Drejtore Shërbimi në Kuvend;
Këshilltar në Kuvend;

Drejtore departamenti në institucionet qendrore buxhetore sipas listës së institucioneve të lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

Drejtore i përgjithshëm në ministri dhe në institucionet qendrore buxhetore të pavarura të krijuara me ligj, sipas listës së institucioneve të lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

Inspektor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;

Drejtore i përgjithshëm i Agjencisë së Trajtimit të Pronës;

Zëvendësdrejtore i përgjithshëm në RTV;

Drejtore i Televizionit;

Drejtore i përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;

Autoriteti për Informim të Dosjeve të Sigurimit të Shtetit;

Kryetari i AIDA-s;

Drejtore i Autoritetit Kombëtar Rrugor;

Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;

Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 Drejtor i përgjithshëm i Meteorologjisë;
 Drejtor i përgjithshëm i Standardizimit;
 Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Zëvendësdrejtor i ATSH-së;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Zëvendësdrejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik;
 Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
 Zëvendëspresident i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 Këshilltar/zëdhënës në ministri;
 Këshilltar/zëdhënës në institucionet qendrore buxhetore të pavarura, të krijuara me ligj, sipas listës së institucioneve të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
 Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror;
 Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
 Drejtor i përgjithshëm i Inspektoratit të Punës;
 Koordinator në Këshillin e Ministrave/Kryeministri;
 Kryeinspektor i Inspektoratit Qendror Teknik;
 Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Kryetari Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
 Kryetar i Gjykatës së Apelit;
 Kryetar i gjykatës së shkallës së parë për Krimet e Rënda;
 Kryetar i gjykatës së shkallës së parë;
 Gjyqtar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
 Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
 Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit;
 Drejtues i Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për Krimet e Rënda;
 Drejtues i Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë;
 Prokuror pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
 Zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit;
 Zëvendëskryetar i gjykatës së shkallës së parë;
 Zëvendësprokuror në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë;
 Inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë;
 Sekretar i Përgjithshëm në institucione të tjera qendrore buxhetore, të pavarura të krijuara me ligj, sipas listës së institucioneve të lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;
 Drejtor Kabineti në institucione të tjera qendrore buxhetore, të pavarura të krijuara me ligj, sipas listës së institucioneve të lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;
Titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit, me përjashtim të funksioneve të shprehura në mënyrë nominative në këtë lidhje;
Drejtor i Përgjithshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme;
Inspektor në Këshillin e Ministrave/Kryeministri;
Drejtues i Prokurorisë për Krime të Rënda;
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit;
Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Për grupin e dytë germa “c”, e pikës 9 të nenit 1, të këtij ligji:

Drejtor drejtorie në institucionet e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
 Kryeauditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Ambasador i Republikës së Shqipërisë;
 Ministër fuqiplotë në ambasadë;
 Auditues i lartë në KLSH;
 Auditues i kategorisë së parë/auditues i brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 Shef/përgjegjës sektori në institucionet e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
 Konsull në konsullatat e Republikës së Shqipërisë;
 Ministër këshilltar në ambasadë;
 Këshilltar në ambasadë;

Sekretar i parë në ambasadë;
 Sekretar i dytë në ambasadë;
 Sekretar i tretë në ambasadë;
 Zëvendëskryetar i Këshillit të Qarkut;
 Jurist në Departamentin Juridik në Kryeministri;
 Nënprefekt;
 Ndihmësinjektor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
 Ndihmës/komisioner pranë Avokatit të Popullit;
 Gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
 Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
 Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë për Krime të Rënda;
 Sekretar i Kryetarit të Kuvendit;
 Sekretar i Kryeministrit;
Zëvendëstitullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit, me përjashtim të emërtimeve të shprehura në mënyrë nominative në këtë lidhje;
Anëtarë të organeve kolegjiale me kohë të plotë;
Shef i protokollit dhe ceremonisë në Presidencë;
Shef i zyrës së pritjes së popullit në Presidencë;
Përgjegjës i sektorit në Presidencë.

Për grupin e dytë germa “d”, e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

Specialist/inspektor/auditues/koordinator/redaktor në institucionet e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
 Auditues i kategorisë së dytë në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve;
 Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë;
 Ndihmësligjor në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Gjyqtarë në gjykatat e apelit;
 Gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit;
 Prokuror pranë gjykatave të apelit;
 Gjyqtarë në gjykatat e shkallës së parë;
 Gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë;
 Prokuror pranë gjykatave të shkallës së parë;
 Hetues, oficer i Policisë Gjyqësore;
 Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë;
 Sekretar i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese;
 Atashe në ambasadë;
 Sekretar i drejtorit të Kabinetit në Presidencë;
 Sekretar i këshilltarit të Presidentit;
 Sekretar i zëvendëskryetarëve të Kuvendit;
 Sekretar i Grupit Parlamentar;
 Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvend;
 Sekretar i komisionit në Kuvend;
 Sekretar për seancën plenare.

Lidhja nr. 3

LISTA PËR FUNKSIONET DHE DETYRAT, TË CILAT MERREN PËR BAZË PËR PËRFITIME SIPAS
 LIGJIT NR. 8097, DATË 21.3.1996, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË
 PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, I
 NDRYSHUAR

Për grupin e parë germa “a”, pika 8, e nenit 1, të këtij ligji:

President i Republikës së Shqipërisë;
 Kryetari i Kuvendit;
 Kryeministër;
 Zëvendëskryeministër;
 Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
 Zëvendëskryetari i Kryesisë së Kuvendit;
 Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

Personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave janë:

Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
 Kryetari i Gjykatës së Lartë;

Kryetari i Komitetit të ish-të Përndjekurve Politike;
Prokuror i Përgjithshëm;
Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
Kryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;
Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
Guvernator i Bankës së Shqipërisë” (VKM nr. 120, datë 8.3.2001).

Për grupin e parë germa “b”, e pikës 8, të nenit 1, të këtij ligji:

Deputetët e Kuvendit;
Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
Anëtarët e Gjykatës së Lartë;
Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
Avokati i Popullit.

Për grupin e dytë germa “a”, e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

Sekretarët e Shtetit;
Zëvendësministrat;
Zëvendësprokurorët e përgjithshëm;
Sekretar i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Avokat i Shtetit në Avokaturën e Përgjithshme (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Drejtor i Kabinetit të Zëvendëskryeministrit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Këshilltar i zëvendëskryeministrit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Ndihmës i Presidentit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Anëtari Komisionit të Shërbimit Civil (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);

dhe personat e tjerë të barazuar me ta si më poshtë:

Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit;
Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;
Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës;
Komisioner në Avokatin e Popullit;
Zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
Kryetari i Akademisë së Shkencave;
Kryetar i Komitetit të Zhvillimit dhe Turizmit;
Kryetari i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
Drejtori i përgjithshëm i RTV-së;
Drejtori i ATSH-së;
Zëvendëskryetar i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
Drejtor i departamentit pranë Kryeministrit;
Këshilltar i Kryeministrit;
Shef i Kabinetit të Kryeministrit;
Zëdhënësi i Kryeministrit;
Zëvendëskryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
Zëvendëskryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;
Kryetari i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
Drejtori i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Shtetërore;
Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
Drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik;
Drejtori i Drejtorisë Qendrore të Shërbimit Qeveritar;
Drejtori i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
Drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve;
Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit;
Zëdhënës i Kuvendit;
Shef i Kabinetit të Kuvendit;
Drejtor i përgjithshëm i Doganave;
Drejtor i përgjithshëm i Policisë Financiare;

Drejtor i përgjithshëm i Policisë Tatimore;
 Zëvendësguvernatori i Bankës së Shqipërisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Inspektor i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Drejtor i përgjithshëm i Bankës së Kursimit;
 Drejtor i përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare;
 Drejtor i përgjithshëm i Bankës Tregtare Agrare;
 Kancelar i Gjykatës së Lartë;
 Prokuror i Gjykatës së Lartë;
 Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil;
 Kryeinspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Shef i Kabinetit të Presidentit;
 Këshilltar i Presidentit;
 Zëdhënës i Presidentit;
 Prefekti;
 Kryetari i këshillit të rrethit;
 Kryetari i këshillit të qarkut;
 Kryetari i Bashkisë;
 Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese;
 Ndihmës i Kryeministrit;
 Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kontrollin e Figurave të Zyrtarëve;
 Kryekoordinator në Departamentin e Koordinimit në Këshillin e Ministrave;
 Kryetari i Grupit Mbikëqyrjes të Shoqërive Huamarrëse;
 Ndihmës i zëvendëskryeministrit;
 Sekretar i Përgjithshëm në prefekturë;
 Sekretar i Përgjithshëm në këshillat e rretheve;
 Sekretar i Përgjithshëm në këshillin e qarkut;
 Sekretar i Përgjithshëm në bashki;
 Drejtor i përgjithshëm i Institutit të Integritetit të Përndjekurve Politikë;
 Inspektor i përgjithshëm i SHIK-ut;
 Sekretar i Përgjithshëm në ministri;
 Drejtor i Kabinetit të Avokatit të Popullit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Sekretar i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtor i Kabinetit të Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtor i Kabinetit të Inspektorit të Përgjithshëm në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Inspektor i Lartë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetar i njësisë bashkiake të Tiranës (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Shërbimit Civil (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtor kabineti në ministri dhe në institucione qendrore/ *buxhetore* (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Anëtar i Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Avokat i Prokurimeve (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Kryeinspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Shef kabineti në Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Anëtar i Grupit Mbikëqyrës të Shoqërive Huamarrëse (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Avokat i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetar i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror (ligji nr. 9061, datë 8.5.2003).

Për grupin e dytë germa “b”, e pikës 9, të nenit I, të këtij ligji:

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
 Zëvendëskryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit;
 Sekretar Shkencor në Akademinë e Shkencave;
 President i Komitetit Olimpik Shqiptar;

Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
 Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
 Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;
 Shef kabiniti i Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
 Avokat Shteti pranë Gjykatës së Apelit në zyrat vendore (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
 Shef i protokollit dhe ceremonisë në Presidencë;
 Shef i zyrës së pritjes së popullit në Presidencë;
 Kryeinspektor në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Drejtor i përgjithshëm në ministri;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm në RTV;
 Drejtor departamenti në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Kryetar i Këshillit të Ankesave në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Drejtor i Radios së Jashtme;
 Drejtor i Radios së Brendshme;
 Drejtor i Televizionit;
 Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
 Kryetar i Qendrës për Nxitjen e Investimeve të Huaja;
 Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit;
 Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve;
 Drejtor i përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;
 Zëvendëskryetar i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
 Drejtor i përgjithshëm i Njesisë së Implementimit të Projektit Mobil;
 Shef i Shërbimit të Inspektoratit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave;
 Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil;
 Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të ministrive dhe institucioneve qendrore/ *buxhetore* (ligji nr. 9061, datë 8.5.2003);
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 Drejtor i ligjshmërisë në Gjykatën e Kasacionit;
 Drejtor i përgjithshëm i ish-të Përndjekurve Politikë;
 Drejtor i Drejtorisë Kombëtare të Meteorologjisë dhe Kalibrimit;
 Drejtor i Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë;
 Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
 Përgjegjës i sektorit në Presidencë;
 Sekretar i Presidentit;
 Kryetar i Komisionit Shtetëror Trepalësh për Dhënien e Statusit të ish-të Përndjekurve Politikë;
 Kryekëshilltar në Kuvend;
 Këshilltar Komisioni në Kuvend;
 Zëvendësdrejtor i ATSH-së;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Zëvendëskryetar i Qendrës Shqiptare të Nxitjes së Investimeve të Huaja;
 Zëvendëskryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
 Zëvendësdrejtor i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
 Zëvendësdrejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik;
 Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
 Zëvendëspresident i Komitetit Olimpik;
 Këshilltar në ministri dhe institucione qendrore/ *buxhetore* (ligji nr. 9061, datë 8.5.2003);
 Drejtor drejtorie (për probleme të veçanta) në Këshillin e Ministrave, Presidencë dhe Kuvend;
 Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekut;
 Zëdhënës i Gjykatës së Lartë;
 Drejtor i përgjithshëm i Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Çështjeve Sociale;

Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
 Drejtor i përgjithshëm i Inspektoratit të Punës;
 Koordinator në Këshillin e Ministrave;
 Drejtor i përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave;
 Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tij;
 Drejtor drejtorie (prokuror) në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Prokuror, hetues, oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Prokuror në prokurorinë e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
 Zëvendësprokuror në Prokurorinë e Rrethit;
 Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
 Zëvendëskryeinspektor dhe inspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Kryetar në gjykatat e rretheve;
 Kryetar i Gjykatës së Apelit në rrethe;
 Prokuror rrethi;
 Zëvendësprokuror rrethi;
 Zëvendëskryetar në gjykatat e rretheve;
 Zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit në Rrethe;
 Inspektor i Kontroll-Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave;
 Këshilltar i Avokatit të Popullit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Gjyqtari Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtues i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Prokuror i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetar i Gjykatës për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtues i Prokurorisë për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Zëdhënës i ministrit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Këshilltar në Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Sekretar i përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 641, datë 11.6.2009).

Për grupin e dytë germa “c” e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

Drejtor drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në Institucionin e Avokaturës së Shtetit, në Institucionin e Avokatit të Popullit, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në Komisionin e Shërbimit Civil (VKM nr. 467, datë 23.6.2005); Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Zëvendësdrejtor në Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Ambasador i Republikës së Shqipërisë;
 Ministër fuqiplotë në ambasadë;
 Shef sektori në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Institucionin e Avokaturës së Shtetit, Institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Konsull në konsullatat e Republikës së Shqipërisë;
 Kryetar dege në ministri, institucione qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Ministër këshilltar në ambasadë;
 Këshilltar në ambasadë;
 Sekretar i parë në ambasadë;
 Sekretar i dytë në ambasadë;
 Sekretar i tretë në ambasadë;

Ndihmës i këshilltarit të Presidentit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Zëvendëskryetar i këshillit të qarkut (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Jurist në Departamentin Juridik në Kryeministri (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Nënprefekti (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Ndihmës/inspektor i lartë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Ndihmës/komisioner i komisionerit të Avokatit të Popullit (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Gjyqtar i Gjykatës për Krime të Rënda (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Prokuror i Prokurorisë për Krime të Rënda (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë për Krime të Rënda (VKM nr. 476, datë 23.6.2005).

Për grupin e dytë germa “d”, e nenit 9, të këtij ligji:

Specialist në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001); në institucionin e Avokaturës së Shtetit, në institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në Komisionin e Shërbimit Civil, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
Sekretar i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
Gjyqtarë në gjykatat e rretheve;
Prokurorë;
Hetues, oficer i Policisë Gjyqësore;
Gjyqtarë në gjykatat e apelit;
Prokuror në Prokurorinë e Apelit;
Sekretar i Kryetarit të Kuvendit;
Sekretar i Kryeministrit;
Atashe në ambasadë;
Asistent i Inspektorit të Kontroll-Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave;
Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Sekretar i shefit të kabinetit në Presidencë (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
Sekretar i këshilltarit të Presidentit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003).

Shënim.

1. Periudha që punonjësit ushtarakë përfitojnë nga ligji nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, përjashtohet.